

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Ekonomike,me gjyqtarin Asllan Krasniqi duke vendosur lidhur me çështjen juridike të paditësit N.T.SH S.F.K S. me seli në P. ndaj të të paditurës B. E. G.P. Prishtinë,në praninë e të të autorizuarëve të palëve ndërgjyqëse (të të autorizuarit me shkrim të palës paditëse I. G. nga P. dhe në prani të të autorizuarit të palës së paditur,avokatit G. N. nga P.),lidhur me kompenzimin e detyrimit në shumën e përgjithshme prej;8.454,13 euro,në seancën e shqyrtimit kryesor të datës;03.11.2015,ndërsa pas marrjes së fjalës përfundimtare të hartuar me shkrim nga palët ndërgjyqëse,me datën;23.11.2015 merr këtë:

A K T G J Y K I M

Aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit S.F.K S. me seli në P..

I.Detyrohet pala e paditur B. E. me seli në P. që shumën e përgjithshme prej;5.736,13 euro (pesë mijë e shtatëqind e tridhjetëe gjashtë euro e trembëdhjetë cent) ti paguaj palës paditëse në emër të kompenzimit të detyrimit,me kamatë ligjore,duke llogaritur nga data e paraqitjes së padisë me datën;27.05.2013 e deri në pagesën definitive,dhe atë në afatin parativ prej 7 (shtatë) ditëve duke llogaritur nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

II.Shpenzimet e procedurës kontestimore pala e paditur detyrohet ti paguaj palës paditëse në shumë prej;250,00 euro,në afatin kohor prej 7 (shtatë) ditëve,duke llogaritur nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

A r s y e t i m

Paditësi N.T.SH S.F.K S. me seli në P. me datën;27.05.2013 ka parashtruar pranë kësaj gjykate padinë e saj ndaj të të paditurës B. E. me seli në P. lidhur me kompenzimin e detyrimit në shumën e përgjithshme prej;8.454,13 euro,me kamatë ligjore prej 8 %,si dhe të bëjë kompenzimin e shpenzimeve të procedurës kontestimore të cilën do të caktoj gjykata nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim,duke kërkuar në të njëjtën kohë nga kjo gjykatë aprovimin e saj si të bazuar,pas administrimit të të gjitha provave relevante të cilat gjinden në shkresat e lëndës.

I autorizuari i paditësit duke u ndërlidhur me rekomandimet e Gjykatës së Apelit ka precizuar kërkesëpadinë në shumën e përgjithshme prej;5.736,13 euro,dhe duke hjek dorë nga shuma prej;2.718,00 euro,duke u arsyetuar se këto shpenzime do ti bartë vet pala paditëse për shkak të incidenteve të ndodhura me datën;07.05.2012.

Gjykata ka aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e precizuar të palës paditëse duke iu referuar dispozitës së nenit 319 paragrafi 1 dhe nenit 506 të LPK-së,pasiqë pala e paditur me asnjë provë të vetme nuk ka paraqitur pranë kësaj gjykate kundërshtimet e saja lidhur me pretendimin e tij për refuzimin e kërkesëpadiisë së palës paditëse.

Gjykata me rastin e vendosjes lidhur me aprovimin e kërkesëpadisë së palës paditëse është bazuar në provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës duke filluar nga kontrata e nënshkruar nga të dy palët ndërgjyqëse me nr.256000-000-SCSE-0008 e datës;25.07.2011,si dhe raportet e incidenteve në të cilat është shkaktuar vjedhja e disa aseteve të të paditurës është vërtetuar në mënyrë të pakontestuar se detyrimi i palës së paditur rrjedh mu nga kjo kontratë.

Lidhur me analizimin,shqyrtimin,konstatimin dhe çmuarjen e të gjitha provave të prezantuara nga palët ndërgjyqëse gjykata është bazuar në nenin 8 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 të LPK-së,ndërsa lidhur me vendosjen për pagesën e borxhit në afatin kohor prej shtatë ditëve si afat paritiv (vullnetar) si është cekur lartë në dispozitivin e këtij aktgjykimi gjykata është bazuar në dispozitat e nenit 509 pika e të LPK-s.

Duke vendosur lidhur me pagesën e kamatës ligjore duke filluar nga data e paraqitjes së padisë me datën;27.05.2013 e deri në pagesën definitive të kompenzimit të detyrimit gjykata është bazuar në dispozitat e nenit 277 paragrafi 1 të LMD-së,si dhe në dispozitën e kontratës në pikën b (e ashtuquajtur si eksponati b) SC-4 ku është paraparë fillimi dhe përfundimi i punëve,andaj gjykata me rastin e llogaritjes së kamatës është nisur nga data e përfundimit të punës sipas përmbajtjes së kësaj kontrate.

Gjykata ka aprovuar kërkesëpadisë e palës paditëse ashtu si është cituar lartë në pikën një të dispozitivit të këtij aktgjykimi lidhur me kompenzimin e detyrimit duke u bazuar dispozitat e nenit 262 paragrafi 1 të LMD-së.

Duke vendosur lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore gjykata është bazuar në dispozitat e nenit 452 paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore të Kosovës,pasiqë pala paditëse ka bërë specifikimin e shpenzimeve të procedurës kontestimore,në fjalën e tij përfundimtare.

Gjykata pas shtjellimit të kësaj çështje juridike ka vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi duke u bazuar në dispozitat e nenit 262 paragrafi 1 dhe nenit 277 paragrafi 1 të LMD-së,nenit 319 paragrafi 1,nenit 506,si dhe nenit 143 paragrafi 1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

-Departamenti për Çështje Ekonomike-
C.nr.155/2015 me datën;23.11.2015

Gjyqtari;
Asllan Krasniqi

UDHËZIME JURIDIKE:Ndaj këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta e ankesës në afatin kohor prej 7 (shtatë) ditëve,duke llogaritur nga dita e pranimit të tij duke iu drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.